



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1365/11 prot.

Datë, 15.09.2021

V E N D I M
Nr. 632/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2021 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-01148-07-16-2021, me objekt “Furnizim vendosje Eko Abdominale dhe Kardiake, në QSU “Nënë Tereza””, me fond limit 3.866.666,66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Ankimues:** “Health & Light” SHPK
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd.11, Shk.4, Ap.4, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 24 e vijues Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.07.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-01148-07-16-2021, me objekt “Furnizim vendosje Eko Abdominale dhe Kardiake, në QSU “Nënë Tereza””, me fond limit

3.866.666,66 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

II.2. Në datën 22.07.2021 operatori ekonomik "Health & Light" SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1995/3 prot., datë 27.07.2021, protokolluar me tonën me nr. 1365/2 prot., datë 30.07.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Me anë të shkresës nr. 1365/3 prot., datë 03.08.2021, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion shtesë dhe dokumentacionin përkatës për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 1995/6 prot., datë 09.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1365/4 prot., datë 11.08.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK dhe me shkresën nr. 1995/3 prot., datë 27.07.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht ankimuesi në ankesën e paraqitur, ndër të tjera ngre pretendime lidhur me shënimin për deklaratën mbi plotësimin e standardit EN 60601-1(IEC 601) ose SSH EN 60601-1-2:2015. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit e ka pranuar pretendimin e mësipërm duke e hequr tërësisht shënimin lidhur me kriterin e kundërshtuar.

II.8. Në datën 13.08.2021 Komisioni i Prokurimit Publik, mori vendimin KPP 476/2021, datë 13.08.2021, ku vendosi:

[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur, e thjeshtuar", me REF-01148-07-16-2021 me objekt "Furnizim

vendosje Eko Abdominale dhe Kardiake, në QSU “Nënë Tereza”, me fond limit 3,866,666.66 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Referuar kërkesës së operatorit ekonomik ankimues për ekspertizë të posaçme, KPP me shkresën nr.1365/5 prot., datë 11.08.2021 me lëndë “Kërkesë”, iu drejtua ekspertit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, si ekspert në pajisjet mjekësore, që të asistonte pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim gjykimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 1335/1 prot., datë 17.08.2021, protokolluar me tonën në datën 18.08.2021 me objekt: “Kthim-përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, kthim-përgjigje nga ana e institucionit Universiteti Politeknik i Tiranës, i cili informon se “*Në përgjigje të shkresës me nr.1365/5 prot., datë 11.08.2021, me anë të së cilës kërkoni pranë Universitetit Politeknik të Tiranës kryerjen e ekspertizës së posaçme për pajisjen “Eko Abdominale dhe Kardiake”, ju bëjmë me dije se kërkesa është adresuar gabim, pasi shërbimi në fjalë nuk është kompetencë e Universitetit Politeknik të Tiranës. Për sa më sipër, ju sugjerojmë që kjo kërkesë duhet ti adresohet Universitetit të Mjekësisë Tiranë.*”

II.11. Në datën 20.08.2021 me shkresën nr.1365/8 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, duke i kërkuar si më poshtë:

“[...] Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është kërkuar ekspertizë e posaçme lidhur me disa specifikime teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, për pajisjen: 1. Eko Abdominale dhe Kardiake. Sa më sipër, në zbatim të nenit 24 e vijues të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neneve 80, 81 dhe 86 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 24 pika 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj, që të propozoni një/disa mjekë specialistë të fushës, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në asnjë fazë të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, për tu paraqitur pranë ambienteve të Komisionit të Prokurimit Publik, në cilësinë e ekspertit të fushës [...]”.

II.12. Në datën 24.08.2021 me anë të komunikimit elektronik zyrtar (me email), autoriteti kontraktor ka dorëzuar më anë të emalit dokumentin “Urdhër Përfaqësimit” Nr.1995/10 prot.,

datë 24.08.2021 të nënshkruar nga titullari i autoritetit kontraktor QSUT, me përmbajtje si më poshtë:

“Urdhëroj:

- 1. Të kryhet përfaqësimi në Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim vendosje Eko Abdominale dhe Kardiake, në QSU “Nënë Tereza”.*
- 2. Të përfaqësojnë Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë në Komisionin e Prokurimit Publik.*
 - B.S – Mjete Radiologe në Shërbimin e Imazherisë*
- 3. Përfaqësuesit e mësipërm të paraqiten pranë KPP-së në datën 26.08.2021, ora 14:00.*
- 4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.”*

II.13. Me anë të shkresës nr. 1365/9 prot., datë 24.08.2021, Komisioni i Prokurimit Publik njoftoi palët në proces, si dhe mjekun specialist, për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 26.08.2021 ora 14:00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.14. Në datën 26.08.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK, Znj B.S, Mjete Radiologe në Shërbimin e Imazherisë, në cilësinë e ekspertit të fushës, përfaqësuesit të autoritetit kontraktor, si dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore Komisioni drejtoi pyetjet ekspertit (mjekut specialist), mbi mënyrën e hartimit të këtyre specifikimeve teknike dhe a janë ato në përputhje me qëllimin dhe funksionin e pajisjes. Gjatë kësaj seance dëgjimore, u mbajt procesverbali përkatës, i cili u nënshkrua nga palët.

II.15. Në datë 31.08.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1365/10 prot., datë 31.08.2021 shkresa e operatorit ekonomik ‘Health & Light’ SHPK. i cili ngre pretendime si më poshtë:

“[...] 1.Thirrja e Znj. B.S, Mjete Radiologe në Shërbimin e Imazherisë në Q.S.U “Nënë Tereza”, si eksperte për vlerësimin e specifikimeve teknike të pajisjes objekt-prokurimi, nuk është i drejtë pasi ajo është një punonjëse në institucionin i cili ka publikuar procedurën e sipërpërmendur të prokurimit [...].

2. Znj. B.S fillimisht ishte dakort me pretendimet tona dhe më pas ndryshoi qëndrim duke kaluar plotësisht në mbrojtjen e interesave të institucionit ku ajo është punësuar.

3. Çuditërisht, në specifikimet teknike të pajisjes është kërkuar një sondë kardiake për COVID dhe nuk është kërkuar sondë për pjesët e vogla, kur historikisht, në pajisjet ekografike të Spitalit Infektiv, një sondë e tillë ka qenë prezente.

4. Gjatë seancës dëgjimore, u pohua që specifikimet teknike kishin ardhur nga shërbimi infektiv. Ne u interesuam pranë këtij shërbimi dhe asnjë mjek nuk është pyetur për specifikimet teknike, as mjeku imazherist. Pra, ajo që ne kërkonim të dinim ishte fakti se mbi baza u vendosën specifikimet teknike? Kësaj pyetje nuk iu dha përgjigje ditën e djeshme.

5. Në spitalin Infektiv nuk ka mjek kardiolog dhe asnjëherë nuk janë bërë ekografi kardiale, në një kohë që ashtu siç përmendëm më sipër mungon sonda për pjesët e vogla, si dhe meqenëse flitet për interesim të vazave, mund të ketë edhe sondë vazale.
[...]"

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimes, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Health & Light" ShPK, se: "[...]Specifikimet teknike të kërkuara janë copy - paste të një kompanie prodhuese aziatike dhe vetëm ajo mund ti përmbushë plotësisht specifikimet e kërkuara nga ju. Kompania që përfaqësojmë që është lider në botë, por jo vetëm ne, por edhe të tjera, megjithëse I tejkalon, 95 % në mënyrë të dukshme specifikimet, ndonjë nuk i përmbush si më poshtë:

- Parametrat e imazhit ne 2D/M
 - Duhet te kete Gain: 0-100 dB
 - Duhet te kete sepaku 8 pika te pozicionimit te fokusit
 - Gray map duhet te jete minimalisht me 15 lloje
 - Colorize Map duhet te jete minimalisht me 20 lloje dhe Off
- Parametrat e imazhit ne Dopler Spektral
 - Duhet te kete Gain: 0-100 dB
 - Duhet te kete volum te kampionit: 0-15mm
 - Gray map duhet te jete me 14 lloje
 - Colorize Map duhet te jete me 19 lloje dhe Off
- Parametrat e imazhit ne Continuous Eëave
 - Minimumi 2 frekuenca te mundshme perzgjedhjeje
 - Korrigjimi i kendit min. $\pm 89^\circ$ (me hap 1°)
 - Shpejtesia 15cm/s-250 m/s
 - PRF: min 78kHz
 - Dynamic range: 120 dB
 - Gray map duhet te jete me 14 lloje
 - Colorize Map duhet te jete me 19 lloje dhe Off.
 - Cine Memory duhet te jete sepaku 4600 frame, Cine revieë: frame by frame/loop, Playback speed 25%, 50%, 100%, 200%.

- *Hyrjet dhe daljet*
 - *Duhet te kete minimalisht 5 porta USB*
 - *Duhet te kete porta dalese per Video Out, S-Video, VGA out, DVI, Audio Out*
- *Sondat*
 - *Sondat duhet te kene minimalisht 64 elemente (phased), 128 elemente (convex)*

Sonde Convex “single cristal” me diapazon jo me pak se 1-6MHZ.

Kombinimin e këtyre specifikimeve janë aq specifik, sa vetëm kompania koreane i përmbush ato[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

SPECIFIKIME TEKNIKE TË VECANTA

- *Duhet te jete e aplikueshme ne ekzaminimet: Abdominale, Kardiologjike*
- *Monitor LED, minimumi 19” me rezolucion (minimalisht) 1366x768*
- *Tilt 10°lart/90°poshte, rrotullim ± 90° majtas-djathtas,*
- *Monitori duhet te kete kontroll te ndricimit dhe kontrastit*
- *Paneli i kontrollit duhet te kete :*
 - *tastiere alfanumerike me funksione me ndricim nga pas*
 - *duhet te kete butona me perdorim te personalizuar nga perdoruesi*
 - *rregullimin e TGC.*
- *Metodat e Ekzaminimit: Duhet te suportojte metodat e ekzaminimit ne: 2D Mode, M-Mode, Harmonic mode, Color M-mode, Anatomical Mode, Color Floë Doppler, Poëer Doppler, Directional PD mode, Pulsed Eave Doppler, Continuous Eave Doppler, Tissue Doppler Imaging, Panoramic, High PRF Doppler.*
- *Duhet te kete formatet e paraqitjes se imazhit : Single, Dual, Quad, Duplex & Triplex Mode*
- *Duhet te kete keto karakteristika e parametra te imazhit:*
 - *Tissue Harmonic Imaging*
 - *Poëer Doppler Imaging and Directional*
 - *HPRF (High Pulse Repeat Frequency)*
 - *Spatial compounding imaging, neopsionet ON/OFF*
 - *Speckle Reduction Imaging*
 - *Frequency C*
 - *Optimizim me njebuton per imazhin 2D, Color, PË*
 - *Colorize*
 - *Dynamic range*
 - *Line density*
 - *Persist*
 - *Beam Steering*
 - *Read/Ërite Zoom*

- *Parametrat e imazhit ne 2D/M*
- *Duhet te kete Gain: 0-100 dB*
- *Duhet te kete sepaku 8 pika te pozicionimit te fokusit*
- *Kontrolli i TGC me 8 pjese*
- *Thellesia e imazhit duhet te jete : min 30cm*
- *Gray map duhet te jete minimalisht me 15 lloje*
- *Colorize Map duhet te jete minimalisht me 20 lloje dhe Off*
- *Duhet te kete funksionin e zmadhimit te imazhit ne real-time dhe te fiksuar*
- *Parametrat e imazhit ne Dopler Spektral*
- *Duhet te kete Gain: 0-100 dB*
- *Duhet te kete volum te kampionit: 0-15mm*
- *Duhet te kete PRF: min. 30kHz*
- *Gray map duhet te jete me 14 lloje*
- *Colorize Map duhet te jete me 19 lloje dhe Off*
- *Duhet te llogarise ne real-time PË, perfshire HR, PS, etj*
- *Duhet te kete perpunim te imazhit: Display Format, Duplex/Triplex, Invert, , Frequency, Speed,SV, Dynamic Range, Gray Map, Tint Map, HPRF, Trace Area, T/F Res, Auto Calc Cycle*
- *Duhet te kete perpunim te mevonshemte imazhit: Gain, Baseline,Dynamic Range,Angle correction,Quick angle,Invert,Gray map,Tint map,Auto calc .*
- *Parametrat e imazhit ne Color/Poëer Doppler*
- *Duhet te kete Gain: 0-100 dB*
- *Duhet te kete PRF: min. 19 kHz*
- *Duhet te kete perpunim te imazhit: Dual Live, B/C Align, Invert, Smooth, ËF, Frequency,Persistence, Packet Size, Dynamic Range, Color Map, Priority, Line Density*
- *Duhet te kete perpunim te mevonshem te imazhit: Invert, Baseline, Map, Priority, Smooth, Dual Live*
- *Parametrat e imazhit ne Continuous Ëave*
- *Minimumi 2 frekuenca te mundshme perzgjedhjeje*
- *Korrigjimi i kendit min. $\pm 89^\circ$ (me hap 1°)*
- *Shpejtesia 15cm/s-250 m/s*
- *PRF: min 78kHz*
- *Dynamic range: 120 dB*
- *Gray map duhet te jete me 14 lloje*
- *Colorize Map duhet te jete me 19 lloje dhe Off.*
- *Ruajtja e Informacionit*
- *Duhet te kete HDD minimalisht 500GB*
- *Cine Memory duhet te jete sepaku 4600 frame, Cine revieë: frame by frame/loop, Playback speed 25%, 50%, 100%, 200%.*
- *Formatet perimazhet me 1 frame duhet te ruhen ne : BMP, JPG, DICOM*

- *Formatet per multi-frame duhet te ruhen ne : AVI, ĘMV*
- *Sistemi I Menaxhimit te informacionit te pacientit*
 - *Duhet te kete funksionin Query/Retrieve per ekzaminimet e pacienteve*
 - *Te suportojte rishikimin e e ekzaminimeve te tanishme dhe te kaluara*
 - *Te suportojte funksionet: Neë exam, Active exam, Continue exam dhe End exam*
 - *Te suportojte matjet dhe llogaritjet mbi imazhet dhe ekzaminimet e arkivuara*
 - *Te suportojte transferimin e me ane te USB dhe DĘD-RĘ te ekzaminimeve*
 - *Te kete minimalisht 380 GB memorje te brendshme te dedikuar per te ekzaminimet e pacienteve*
- *Raporti duhet te jete i redaktueshem*
 - *Ne raport te kete mundesine qe te zgjidhen imazhet*
 - *Drafti raporti duhet te jete i rregullueshem nga perdoruesi*
 - *Raporti te kete mundesine te eksportohet ne formatin PDF*
- *DICOM 3.0*
 - *Duhet te kete opsion qe te behet upgrade DICOM3.0 me keto karakteristika: DICOM Verify/Print/Store/Storage Commitment/Media Exchange; DICOM Ęorklist; DICOM, Query/Retrieve; MPPS*
- *Matjet dhe llogaritjet*
 - *Duhet te kete paketat e matjeve per Kardiologjike, Vaskulare, Abdominale, Pjeset e imta , etj*
 - *Duhet te kete matjet basike si: Distancen, Siperfaqen, Volumin, Kendin, Kohen , Pjerresine, Shpejtesine, Shpejtsine e gradientit, Ritmin e zemres, etj.*
 - *Duhet te kete keto matje te pergjithshme : Ne 2D mode: Depth, Distance, Angle, Area: Ellipse, Trace, Spline, Cross, Trace Length, Double Distance, Parallel, Volume: 3-Distance, Ellipse, Ellipse + Distance, Length Ratio, Area Ratio, IMT, 2D Histogram, Volume Floë.*
 - *M mode: Distance, Time, Slope, Velocity, Heart Rate*
 - *Doppler mode: D Velocity, Time, Heart Rate, Volume Floë, Açeleration, PS/ED, D Trace*
- *Hyrjet dhe daljet*
 - *Duhet te kete minimalisht 5 porta USB*
 - *Duhet te kete porta dalese per Video Out, S-Video, VGA out, DVI, Audio Out*
 - *Duhet te kete port Ethernet dhe Remote*
 - *System Poëer: 220-240 V, AC, 50 Hz*
- *Sondat:*
 - *Sondat duhet te kene minimalisht 64 elemente (phased), 128 elemente (convex)*
 - *Sondat te jene te pajisura me teknologjine Single Cristal per eliminimin maksimal te zhurmave dhe sensitivitet te larte*
 - *Duhet kene metoden e skanimit: Electronic convex (field of vieë min.60°), Electronic phased(field of vieë min 90°)*
 - *Duhet te suportojte sondat : - Lineare , Convexe, Endocavity, Phased, Pencil*
 - *Te suportojne opsionin per mbikqyrje Biopsie .*
 - *Aparati te shoqerohet me dy sonda ku:*

- *Sonde Convex “single cristal” me diapazon jo me pak se 1-6MHZ*
- *Sonde Phased Array “single cristal” me diapazon jo me pak se 1-5MHz*
- *Pajisja duhet të jetë e certifikuar me standartin IEC 60601-1-11: 2015 “Pajisjet elektrike mjekësore - Pjesa 1-11: Kërkesa të përgjithshme për sigurinë themelore dhe performancën thelbësore - Standard kolateral: Kërkesat për pajisjet elektrike mjekësore dhe sistemet elektrike mjekësore të përdorura në mjedisin e kujdesit shëndetësor”. Shënim: Certifikimi i pajisjeve me standartin IEC 60601-1-11: 2015 është vendosur në përputhje me rekomandimet/udhëzimet e Komisionit European dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi pajisjet mjekësore, të nevojshme për përdorim në luftën kundër COVID-19.*

III.1.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor, ky i fundit ka pranuar pjesërisht modifikimin e këtyre specifikimeve si më poshtë:

- *Parametrat e imazhit ne 2D/M*
 - *Duhet te kete Gain: 0-90 dB*
 - *Duhet te kete sepaku 8 pika te pozicionimit te fokusit*
 - *Gray map duhet te jete minimalisht me 8 lloje*
 - *Colorize Map duhet te jete minimalisht me 8 lloje dhe Off*
- *Parametrat e imazhit ne Dopler Spektral*
 - *Duhet te kete Gain: 0-90 dB*
 - *Duhet te kete volum te kampionit: 0-15mm*
 - *Gray map duhet te jete me minimalisht 8 lloje*
 - *Colorize Map duhet te jete me minimalisht 8 lloje dhe Off*
- *Parametrat e imazhit ne Continuous Eëve*
 - *Minimumi 2 frekuenca te mundshme perzgjedhjeje*
 - *Korrigjimi i kendit min. $\pm 89^\circ$ (me hap 1°)*
 - *Shpejtesia 15cm/s-50 m/s*
 - *PRF: min 78kHz – nuk e ka pasqyruar në ndryshim*
 - *Dynamic range: 120 dB*
 - *Gray map duhet te jete me minimalisht 8 lloje*
 - *Colorize Map duhet te jete me minimalisht 8 lloje dhe Off.*
 - *Cine Memory duhet te jete sepaku 4600 frame, Cine revieë: frame by frame/loop, Playback speed 25%, 50%, 100%, 200%.*
- *Hyrjet dhe daljet*
 - *Duhet te kete minimalisht 4 porta USB*
 - *Duhet te kete porta dalese per Video Out ose/dhe S-Video, VGA out ose/dhe DVI, Audio Out*
- *Sondat*
 - *Sondat duhet te kene minimalisht 64 elemente (phased), 128 elemente (convex)*
 - *Sondat duhet të jenë të pajisura me teknologjinë Single Cristal, ose ekuivalent për eliminimin maksimal të zhurmave dhe sensitivitet të lartë*

- *Sonde Convex “single cristal”, ose ekuivalent me diapazon jo me pak se 1-6MHZ*
- *Sonde Phased Array “single cristal”, ose ekuivalent me diapazon jo më pak se 1 – 5 MHz.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare,

miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo

sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*"

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" parashikohet se: "*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.*" Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP

thekson se, fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.1.7. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.8. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “*Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efijencën, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.*”

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, nisur edhe nga vetë kërkesa e operatorit ekonomik ankimes për ekspertizë të posaçme, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi autoritetit kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, që të propozonte një/disa mjekë specialistë të fushës, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në asnjë fazë të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për tu paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në cilësinë e ekspertit të fushës. Për këtë arsye,

KPP organizoi një seancë dëgjimore midis përfaqësueve të operatorit ekonomik ankimes, përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe mjekut specialist të fushës, në cilësinë e ekspertit të posaçën, në lidhje me specifikimet teknike të procedurës objekt-shqyrtimi. Gjatë seancës në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e pajisjes të secilës prej specifikimeve teknike të cilat pretendohen nga ankuesi se janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Gjithashtu, për ankuesin u drejtuan pyetje për secilin prej pretendimeve të tyre, nëse ky i fundit bie dakort me ndryshimet e kryera nga autoriteti kontraktor, si dhe në drejtim të provueshmërisë së faktit se përse specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të ndikojnë në kufizimin e konkurrencës. Gjithashtu, KPP iu drejtua mjekut specialist për secilin nga specifikimet teknike për të cilat operatori ekonomik ankimes ngre pretendime, rolin e tyre dhe a janë këto specifikime në përputhje me qëllimin dhe funksionin e pajisjes, si dhe a i shërben funksionalitetit dhe qëllimit të pajisjes hartimi në mënyrë kaq të detajuar i specifikimeve teknike.

III.1.9. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes si dhe pretendimeve dhe argumenteve të parashtruara nga ky i fundit gjatë seancës dëgjimore të mbajtur në datë 26.08.2021 në mjediset e KPP, vëren se operatori ekonomik “Health & Light” shpk, kërkon modifikimin e këtyre specifikimeve me pretendimin, se këto të fundit të orientojnë drejt prodhuesve kinezë dhe koreanë dhe nuk përmbushen dot nga produktet që ankimesi dhe disa prodhues të tjerë ofrojnë, pasi specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë tepër të ulëta.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet se, ky i fundit ka pranuar pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimes duke i ulur këto parametra, por gjatë seancës dëgjimore, në pyetjen e ngritur nga Komisioni i Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimes deklaroi, se nuk bie dakort me këto ndryshime, pasi ai i konsideron specifikime minimaliste, tepër të ulëta të cilat orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm, por pa argumentuar teknikisht se si ndikojnë këto parametra në funksionalitetin e pajisjes. Vlen të theksojmë se, roli kryesor i KPP, është verifikimi në bazë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, nëse kriteret e kualifikimit apo specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe verifikimi se këto kritere ofrojnë trajtim të barabartë, nuk janë diskriminuese dhe nuk cenojnë konkurrencën e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor (ashtu siç pretendon ankimesi) nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incumbit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat

administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin, se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ ndërkombëtar me reputacion.

Akoma më tej, nisur nga vetë kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për ekspertizë të posaçme, KPP, i kërkoi autoritetit kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, që të propozonte një/disa mjekë specialistë të fushës, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në asnjë fazë të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për t’u paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në cilësinë e ekspertit të fushës. Më anë të Urdhrit të Përfaqësimit Nr.1995/10 prot. datë 24.08.2021, u paraqit në Seancën degjimore të mbajtur në datë 26.08.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, znj. B.S, Mjeko Radiologe në Shërbimin e Imazherisë, e cila deklaroi se nuk ka qenë pjesë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike, por në cilësinë e specialistit të fushës shpreh dakordësinë në lidhje me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, si dhe bie dakort edhe me modifikimet e kryera nga ky i fundit, pasi është arritur një konkluzion i pranueshëm, i cili i shërben hapjes së konkurrencës. Gjithashtu, mjeku specialist deklaroi, se kjo pajisje kërkohet të vihet në përdorim pranë shërbimit infektiv dhe për këtë rast pajisja me këto specifikime është e mjaftueshme dhe i shërben qëllimit për të cilin do të përdoret.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë në lidhje me pajisjen *Eko abdominale dhe kardiace*, specifikime teknike dhe parametra minimale të cilat nuk cenojnë konkurrencën dhe nuk janë diskriminuese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ndërkohë operatori ekonomik ankimues, si në ankesën e paraqitur ashtu edhe gjatë seancës degjimore, në asnjë moment nuk ka parashtruar argumente, se si specifikimet teknike të ankimuar prej tij, ndikojnë konkretisht në kufizimin e konkurrencës dhe në trajtimin e barabartë të operatorëve, por ka ngritur pretendime të përgjithshme në lidhje me këto specifikime.

Referuar pretendimeve të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, me anë të shkresës të protokolluar në KPP me nr.1365/10 prot., datë 31.08.2021, sqarojmë se, pikë së pari, për sa i përket pretendimeve të ankimuesit në lidhje me mjekun Znj. B.S, Mjeke Radiologe në Shërbimin e Imazherisë pranë QSUT, e pranishme në cilësinë e ekspertit, bëjmë me dije se, ankimuesi në asnjë moment gjatë seancës dëgjimore nuk ngriti pretendime në lidhje me prezencën e mjekut dhe nuk kontestoi deklaratimet e këtij të fundit. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore mjeku specialist për asnjë moment nuk mbështeti pretendimet e palës ankimues (referuar procesverbalit të mbajtur gjatë kësaj seance), ndryshe nga sa pretendon operatori ekonomik ankimues në shkresën e mësipërme. Se dyti, lidhur me specifikimet teknike dhe nevojat e institucionit për pajisjet objekt-prokurimi, ritheksojmë se është në të drejtën e autoritetit kontraktor, si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, të përcaktojë nevojat e tij për furnizimin me pajisjet e nevojshme dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe që i shërbejnë qëllimit për të cilin do të përdoret kjo pajisje.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, operatori ekonomik ankimues, si në ankesën e tij, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore, nuk ka paraqitur asnjë argument se si specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor ndikojnë në kufizimin e konkurrencës, por vetëm ka ngritur pretendime të përgjithshme se këto specifikime janë tepër të ulëta, në një kohë kur autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk ka parashikuar në kritere apo deklaruar gjatë seancës dëgjimore, se nuk do të pranohen apo do të refuzohen ofertat ekonomike me specifikime më të larta se ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në përfundim, KPP gjykon, se për sa kohë operatori ekonomik si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore ngre pretendime vetëm mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike, duke pretenduar në total se janë vendosur specifikime teknike të ulta të cilat disa prodhues nuk mund ti përmbushin, por pa argumentuar se si ndikojnë këto specifikime në funksionalitetin e pajisjes dhe në qëllimin e përdorimit të saj, si dhe referuar deklaratimeve të mjekut specialist të fushës (jo pjesë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike), i cili bie dakort me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor për procedurën objekt shqyrtimi, rrjedhimisht këto specifikime do të konsiderohen të rregullta dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-01148-07-16-2021, me objekt “Furnizim vendosje Eko Abdominale dhe Kardiake, në QSU “Nënë Tereza””, me fond limit 3.866.666,66 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri